

VENDIM
Nr. 4, datë 23.2.2026

PËR KORRIGJIMIN E DISA GABIMEVE MATERIALE NË RREGULLOREN
“PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMITETIT TË REGJISTRIMIT
DHE PËRDITËSIMIN E REGJISTRIT PUBLIK”, MIRATUAR ME VENDIMIN NR.
53, DATË 26.11.2025, TË BORDIT TË MBIKËQYRJES PUBLIKE

Në zbatim të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 786, datë 9.11.2016, “Për procedurat e përzgjedhjes dhe rastet e shkarkimit të anëtarëve si dhe rregullat e organizimit e të funksionimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike”, të ndryshuar, si dhe të rregullores, “Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit të Regjistrimit dhe përditësimin e Regjistrit Publik”, të miratuar me vendimin nr. 53, datë 26.11.2025, Bordi i Mbikëqyrjes Publike në mbledhjen e tij, sipas rendit të ditës,

VENDOSI:

1. Të miratojë korrigjimet e gabimeve materiale të propozuara për rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit të Regjistrimit dhe përditësimin e Regjistrit Publik”, miratuar me vendimin nr. 53, datë 26.11.2025 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike, si më poshtë vijon:

1. Në nenin 6, të bëhen ndryshimet si më poshtë:
 - a. Në pikën 2, shkronja “d” zëvendësohet me shkronjën “ç”.
 2. Në nenin 11, të bëhen ndryshimet si më poshtë:
 - a. Në pikën 1, renditja e shkronjave “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, “e”, “ë”, “f”, “gj”, “g” zëvendësohet me “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, “e”, “ë”, “f”, “g”, “gj”.
 3. Në nenin 16, të bëhen ndryshimet si më poshtë:
 - a. Në pikën 3, renditja e shkronjave “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, “e”, “ë”, “f”, “gj”, “g” zëvendësohet me “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, “e”, “ë”, “f”, “g”, “gj”.
 4. Në nenin 20, të bëhen ndryshimet si më poshtë:
 - a. Struktura e shkronjave riorganizohet, duke u zëvendësuar renditja ekzistuese me këtë renditje: “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”.
2. Të ngarkojë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi, strukturën mbështetëse të Bordit të Mbikëqyrjes Publike për reflektimin e korrigjimeve materiale në tekstin e rregullores dhe botimin e saj në formën e korrigjuar.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar: Dritan Fino

Anëtarë: Adriana Berberi, Luan Abazi, Gjergji Duro, Martin Mici

RREGULLORE

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMITETIT TË REGJISTRIMIT DHE
PËRDITËSIMIN E REGJISTRIT PUBLIK

Miratuar me vendimin nr. 53, datë 26.11.2025, të Bordit të Mbikëqyrjes Publike

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

1. Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë:

- a) Rregullat dhe procedurat për organizimin, funksionimin e Komitetit të Regjistrimit të audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese, si edhe mbikëqyrjen e respektimit të rregullave gjatë procesit të regjistrimit në Regjistrin Publik të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit, në lidhje me numrin e identifikimit të audituesve ligjorë në regjistër;
- b) Procedurat që zbatohen për regjistrimin e audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese në përputhje me objektin e veprimtarisë së Komitetit të Regjistrimit;
- c) Procedurat e mbajtjes dhe përditësimit të regjistrit publik nga organizata profesionale e audituesve ligjorë;
- ç) Mbikëqyrjen e veprimtarisë së komitetit të regjistrimit dhe organizatës profesionale të audituesve ligjorë.

Neni 2 Baza Ligjore

Kjo rregullore hartohet në zbatim të nenit 5 pika 1 shkronja ‘a’ dhe shkronja ‘c’, nenit 11, pika 3, nenit 12, pika 2, shkronja ‘dh’, nenit 19, nenit 20, nenit 21, nenit 22, nenit 23, nenit 24, nenit 25, pika 8, nenit 26, nenit 27, nenit 28 dhe nenit 29, nenit 30, nenit 31, nenit 32, pika 2, nenit 55, nenit 55/1 dhe nenit 55/2, të ligjit nr. 10 091, datë 5.3.2009, ‘Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar’ i ndryshuar.

Neni 3 Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet për audituesit ligjorë, shoqëritë audituese, komitetin e regjistrimit dhe organizatën profesionale të audituesve ligjorë.

Neni 4 Përkufizime

Për qëllime të kësaj rregullore zbatohen përkufizimet e parashikuara në nenin 2 të ligjit për auditimin.

KREU II ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KOMITETIT TË REGJISTRIMIT

Neni 5 Krijimi dhe përbërja

1. ‘Komiteti i regjistrimit’ është struktura e organizatës profesionale të audituesve ligjorë, që merret me procedurat e regjistrimit dhe çregjistrimit në regjistrin publik të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit.

2. Komiteti i Regjistrimit përbëhet nga pesë anëtarë, të cilët emërohen nga Këshilli Drejtues i organizatës profesionale të audituesve ligjorë për një periudhë katërvjeçare, sipas propozimeve të mëposhtme:

- a) tre anëtarë, nga Këshilli Drejtues i organizatës profesionale të audituesve ligjorë;
- b) dy anëtarë, respektivisht nga ministria përgjegjëse për financat dhe ekonominë, me profil në fushën e ekonomisë dhe/ose jurisprudencës, si dhe me njohuri në fushën e kontabilitetit, auditimit dhe financës.

3. Të paktën dy prej anëtarëve të propozuar nga Këshilli Drejtues duhet të përzgjidhen nga anëtarësia e organizatës profesionale të audituesve ligjorë. Kryetari i Komitetit të Regjistrimit përzgjidhet një nga anëtarët e propozuar të organizatës profesionale të audituesve ligjorë.

4. Me propozim të Kryetarit, njëri nga anëtarët e propozuar sipas pikës 2 (b) të këtij neni përzgjidhet nënkryetar me votën e shumicës së anëtarëve të Komitetit të Regjistrimit.

5. Anëtarët e Komitetit të Regjistrimit nuk duhet të mbajnë funksione ekzekutive në organizatën profesionale të audituesve ligjorë.

6. Anëtarët e Komitetit të Regjistrimit nuk duhet të jenë në kushtet e konfliktit të interesit në ushtrimin e kompetencave të tyre. Në rastet e konfliktit të përkohshëm të interesit, anëtari duhet të marrë masat për shmangien e konfliktit.

7. Kur një anëtar i Komitetit të Regjistrimit gjendet në kushtet e konfliktit të interesit në lidhje me një çështje konkrete (përfshirë, por pa u kufizuar, lidhje familjare, marrëdhënie ortakërie, marrëdhënie punësimi ose konflikt gjyqësor me kërkuesin), ai është i detyruar të vetë përjashtohet nga shqyrtimi dhe votimi për atë çështje. Rasti i konfliktit të interesit dhe vetë përjashtimi i anëtarit pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes.

8. Anëtarët e Komitetit të Regjistrimit kanë të drejtën e një shpërblimi fiks për ditë të pjesëmarrjes në veprimtarinë e organit përkatës. Masa e këtij shpërblimi miratohet nga Bordi, sipas propozimit të Këshillit Drejtues.

Neni 6

Lirimi dhe shkarkimi i anëtarëve të Komitetit të Regjistrimit

1. Anëtari i Komitetit të Regjistrimit lirohet nga detyra në rastet kur:

- a) i mbaron mandati;
- b) jep dorëheqjen;
- c) çregjistrohet nga regjistri publik, ose ka pezulluar përkohësisht ushtrimin e veprimtarisë si auditues ligjor;

ç) përfundon marrëdhënia e punës me institucionin që ai përfaqëson, në rastet kur anëtari emërohet në përputhje me pikën 2, shkronja “b”, e nenit 2 të kësaj rregulloreje dhe me pikën 2, shkronja “b”, të nenit 19 të ligjit për auditimin;

2. Këshilli Drejtues i organizatës profesionale të audituesve ligjorë ka të drejtë të shkarkojë një anëtar të Komitetit të Regjistrimit, kur:

a) Nuk merr pjesë, pa arsye, në mbledhjet e Komitetit të Regjistrimit për më shumë se tre herë radhazi;

b) Veprimet apo mosveprimet e tij kanë dëmtuar ndjeshëm reputacionin, veprimtarinë dhe emrin e organizatës profesionale të audituesve ligjorë, Komitetit të Regjistrimit dhe Bordit të Mbikëqyrje Publike, sipas parashikimeve të nenit 24 të ligjit të auditimit;

c) Nuk zbaton dispozitat e ligjit të auditimit, të kësaj rregulloreje dhe rregulloreve të tjera të lidhura me procesin e regjistrimit;

ç) Për shkaqe sëmundjesh fizike ose mendore, gjë që i bën të paaftë për të kryer funksionet e ngarkuara.

3. Këshilli Drejtues, në rastet kur anëtari i Komitetit të Regjistrimit lirohet ose shkarkohet nga funksioni, duhet të caktojë zëvendësuesin e tij brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditësh, duke filluar nga data e njoftimit, në përputhje me kërkesat dhe kriteret e emërimit.

4. Mandati i zëvendësuesit llogaritet për pjesën e mbetur nga dita e emërimit të tij.

Neni 7

Objekti i veprimtarisë së Komitetit të Regjistrimit

1. Për zbatimin e procedurave të regjistrimit në regjistrin publik të audituesve ligjorë dhe të shoqërive të auditimit, Komiteti i Regjistrimit ka si objekt të veprimtarisë:

- a) Regjistrimin e audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese në regjistrin publik;
- b) Fshirjen e përkohshme nga regjistri publik;
- c) Ri regjistrimin në regjistrin publik;
- ç) Regjistrimin e përvitshëm në regjistrin publik;
- d) Çregjistrimin e audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese;
- dh) Regjistrimin e kandidatëve që kanë fituar titullin e audituesit ligjor.

2. Komiteti i Regjistrimit harton dhe i paraqet BMP-së, brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, raportin vjetor të veprimtarisë me përmbajtjen si më poshtë:

- a) Përbërja dhe Detyrat e Komitetit të Regjistrimit:

Përshkrim i përbërjes, mandati i Komitetit të Regjistrimit, kuadri ligjor dhe rregullator i veprimtarisë etj.;

- b) Aktivitetet kryesore gjatë vitit

Pasqyrimi i veprimtarive sipas objektit të veprimtarisë:

i. Regjistrimet: numri i audituesve ligjorë dhe i shoqërive audituese të regjistruara gjatë vitit (të reja);

ii. Regjistrimet e përvitshme: numri i audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese;

iii. Ri-regjistrimet: numri i audituesve ligjorë të ri-regjistruar pas pezullimit të përkohshëm;

iv. Fshirjet e përkohshme: numri i rasteve të pezullimit dhe arsytet përkatëse;

v. Çregjistrimet: numri i çregjistrimeve përfundimtare dhe arsytet përkatëse;

- c) Të dhëna statistikore dhe Analiza:

i. Krahasimi me vitet e mëparshme për të evidentuar ndryshime në numrin e regjistrimeve/çregjistrimeve;

ii. Identifikimi i prirjeve (p.sh., rritja e shoqërive të reja audituese, ulja e ri-regjistrimeve, arsye të përsëritura për çregjistrim);

iii. Informacion mbi strukturën e pronësisë të shoqërive audituese;

- ç) Çështje sfiduese dhe masa të marra:

i. Probleme të hasura gjatë zbatimit të procedurave (p.sh., mangësi në dokumentacionin e aplikimeve);

ii. Vendime ose masa korrigjuese që ka marrë Komiteti;

- d) Bashkëpunimi institucional:

i. Marrëdhëniet me BMP-në, Këshillin Drejtues të IEKA-s lidhur me veprimtarinë e Komitetit të Regjistrimit.

ii. Koordinimi me strukturat e tjera përkatëse të IEKA-s;

- dh) Përfundime dhe rekomandime:

i. Përmbledhje e rezultateve kryesore të vitit;

ii. Rekomandime për përmirësimin e procedurave në të ardhmen.

Neni 8

Mbledhja dhe vendimmarrja

1. Komiteti i Regjistrimit mbledhet me thirrjen e Kryetarit të tij, një herë në dy muaj në javën e parë të muajit pasardhës. Në mungesë të kryetarit dhe me porosi, mbledhjet thirren dhe drejtohen nga nënkryetari.

2. Kryetari i Komitetit të Regjistrimit, në bashkërendim me drejtorin ekzekutiv të IEKA-s, përcakton një person nga struktura organizative e organizatës profesionale të audituesve ligjorë, i cili ushtron funksionin e sekretarisë teknike të Komitetit.

3. Anëtarët e Komitetit njoftohen nga sekretaria teknike e organizatës profesionale të audituesve ligjorë me kërkesë të kryetarit, ose sipas dispozitave të parashikuara në pikën 1 të

këtij neni, të paktën 5 ditë para datës së mbledhjes. Njoftimi përmban datën, orën, rendin e ditës, si edhe relacionin sipas rendit të ditës.

4. Komiteti Regjistrimit është përgjegjës për të shqyrtuar kërkesat dhe dokumentacionin përkatës, si edhe të përgatisë relacionin lidhur me këto kërkesa.

5. Kryetari i Komitetit të Regjistrimit mban kontakte dhe komunikim të vazhdueshëm me Këshillin Drejtues, duke u informuar lidhur me kërkesat e paraqitura.

6. Mbledhjet e Komitetit të Regjistrimit janë të vlefshme kur në të marrin pjesë jo më pak se 3 anëtarë. Këto mbledhje dokumentohen me procesverbal, i cili nënshkruhet nga Kryetari dhe nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës.

7. Vendimet merren me shumicën e votave (jo më pak se tre vota), të jenë të arsyetuara dhe të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët, në përputhje me dispozitat e kësaj rregullore. Votat kundër duhet të jenë të argumentuara në procesverbalin e mbledhjes.

8. Vendimet e Komitetit të Regjistrimit arkivohen në dosjen e audituesit ligjor ose shoqërisë audituese, në selinë e organizatës profesionale të audituesve ligjorë.

9. Vendimet për mos pranimin e kërkesave për t'u regjistruar/ç'regjistruar në regjistrin publik të organizatës profesionale të audituesve ligjorë duhet të jenë të arsyetuara.

10. Sekretaria teknike do të kryejë njoftimin e vendimit të Komitetit të Regjistrimit, me shpresë apo nëpërmjet postës elektronike të audituesit ligjor ose shoqërisë audituese, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e mbledhjes.

11. Vendimet e Komitetit të Regjistrimit duhet të reflektohen në regjistrin publik të audituesve ligjorë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e mbledhjes.

12. Gjatë shqyrtimit të kërkesave, Komiteti i Regjistrimit udhëhiqet nga parimi i pjesëmarrjes së kandidatit në procedurë, duke siguruar vënien e tij në dijeni, të drejtën për t'u dëgjuar, si dhe trajtimin dhe verifikimin e rastit në mënyrë të njëjtë dhe të barabartë me raste të tjera

13. Kur e gjykon të nevojshme, Komiteti i Regjistrimit organizon seanca dëgjimore të kandidatit, që ka paraqitur kërkesën.

14. Secili prej anëtarëve të Komitetit të Regjistrimit, kur gjykon se procedurat e ndjekura lidhur me funksionet dhe vendimmarrjen e komitetit nuk janë zbatuar në pajtueshmëri me këtë rregullore apo me legjislacionin në fuqi, vë në dijeni BMP-në, lidhur me parregullsitë e procesit.

KREU III PROCEDURAT E REGJISTRIMIT TË AUDITUESVE LIGJORË DHE TË SHOQËRIVE AUDITUESE

Neni 9

Ushtrimi i profesionit

1. Audituesi ligjor mund ta ushtrojë profesionin:

a) në mënyrë individuale;

b) si një ortak/aksionar pjesëmarrës në kapitalin e një shoqërie audituese;

c) i punësuar tek një tjetër auditues ligjor i regjistruar.

2. E drejta për kryerjen e veprimtarisë së auditimit ligjor, të pasqyrave financiare individuale dhe/ose të konsoliduara të shoqërive tregtare, si edhe për kryerjen e shërbimeve të tjera apo shërbimeve të lidhura, kur ato nuk bien ndesh me kërkesat e parashikuara në ligjin e auditimit, me standardet profesionale dhe me kodin e etikës, fillon nga momenti i regjistrimit të audituesit ligjor ose shoqërisë audituese në regjistrin publik.

Neni 10

Regjistrimi i audituesve ligjorë në regjistrin publik

1. Regjistrimi i audituesve ligjorë është procesi i përfshirjes së tyre në regjistrin publik të audituesve ligjorë.

2. Kandidati, i cili ka përfunduar me sukses praktikën profesionale tre vjeçare dhe provimet e aftësisë profesionale, i drejtohet me shkrim Komitetit të Regjistrimit përmes organizatës profesionale të audituesve ligjorë për t'u regjistruar si auditues ligjor.

3. Kandidati mban përgjegjësi personale për eliminimin e çdo papajtueshmërie që pengon ushtrimin e profesionit në praktikë, si dhe për garantimin e integritetit etik, moral dhe të reputacionit të mirë.

4. Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentet e përcaktuara në nenin 11 të kësaj rregulloreje.

Neni 11

Dokumentacioni për regjistrimin e audituesve ligjorë

1. Kërkesa për regjistrim për herë të parë në regjistrin publik, për audituesit ligjorë shtetas shqiptarë, duhet të shoqërohet me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kërkesë për regjistrim e nënshkruar nga kandidati;
 - b) *Curriculum vitae*;
 - c) Dokument identifikimi biometrik i vlefshëm;
 - ç) Vërtetim nga prokuroria e rrethit se ndaj personit nuk është filluar çështje penale për vepra të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 4, të nenit 24, të ligjit për auditimin;
 - d) Vërtetim nga gjykata e rrethit se ndaj personit nuk është caktuar masë për vepra të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 4, të nenit 24, të ligjit për auditimin;
 - dh) Certifikatë e gjendjes gjyqësore (dëshmi penalteti), që tregon se personi nuk është i dënuar për asnjë vepër penale të kryer në fushën e shërbimeve profesionale të auditimit ligjor, të kontabilitetit dhe konsulencës, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;
 - e) Kopje e njehsuar e certifikatës së titullit auditues ligjor ose vërtetimin për përfundimin me sukses të provimeve të aftësive profesionale dhe përfundimin me sukses të praktikës profesionale;
 - ë) Deklaratë noteriale e lëshuar në përgjegjësinë personale të individit, për dhënien fund të papajtueshmërive, që kërkohen për ushtrimin e profesionit në praktikë dhe për garancitë etike e morale dhe të reputacionit të mirë;
 - f) Certifikatën e regjistrimit dhe kopje të ekstraktit historik nga regjistri tregtar;
 - g) Vërtetim për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore;
 - gj) Të dhëna e tjera, sipas nenit 28, të ligjit nr. 10091/2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.
2. Dokumentacioni që paraqitet për regjistrimin e audituesit ligjor të huaj në regjistrin publik të audituesve ligjorë përcaktohet në aktin nënligjor të miratuar nga Ministri i Financave.

Neni 12

Regjistrimi i shoqërive audituese në regjistrin publik

1. Komiteti i Regjistrimit e regjistron një shoqëri audituese për kryerjen e auditimit ligjor të pasqyrave financiare, individuale dhe/ose të konsoliduara të shoqërive tregtare, që veprojnë në Republikën e Shqipërisë, në qoftë se shoqëria audituese plotëson kushtet e mëposhtme:

a) është themeluar në përputhje me kërkesat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe, kur është e huaj, është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

b) shumica e të drejtave të votës në kapitalin e shoqërisë zotërohen nga shoqëri audituese, vendase ose të huaja, ose nga auditues ligjorë;

c) shumica deri në maksimumin 75 për qind e anëtarëve të organit drejtues ose administrativ të shoqërisë audituese janë auditues ligjorë, vendas ose të huaj, të njohur nga Komiteti i Regjistrimit dhe të regjistruar në regjistrin publik të audituesve ligjorë. Kur organi drejtues ose administrativ nuk ka më shumë se dy anëtarë, të paktën njëri prej këtyre anëtarëve duhet të plotësojë kushtet e përmendura në këtë shkronjë;

ç) shoqëria angazhon auditues ligjorë, vendas ose të huaj, të cilët janë të regjistruar në regjistrin publik të audituesve ligjorë;

d) shoqëria gëzon reputacion të mirë.

2. Për qëllime të shkronjës “d”, të pikës 1 të këtij neni, reputacioni i mirë i një shoqërie audituese konsiderohet, por pa u kufizuar, në rastet kur anëtarët e organit drejtues ose administrativ të shoqërisë audituese, audituesit ligjorë të regjistruar ose punësuar pranë shoqërisë audituese plotësojnë kushtet sipas dokumentacionit të parashikuar në nenin 13 të kësaj rregulloreje në lidhje me vërtetimin për gjendjen gjyqësore, dëshminë e penaltetit, si edhe nuk vërtetohen situatat e parashikuara në pikën 4 të nenit 24 të ligjit për auditimin.

Neni 13

Dokumentacioni për regjistrimin e shoqërive audituese

1. Kërkesa për regjistrim për herë të parë në regjistrin publik, duhet të shoqërohet me dokumentacionin si më poshtë:

a) Për shoqëritë audituese:

i. Certifikatë regjistrimi dhe Ekstrakt historik i Regjistrit Tregtar të QKB-së;

ii. Ekstrakt për të dhënat e regjistruara në Regjistrin e Pronarëve Përfitues;

iii. Vendimi i asamblesë së ortakëve/aksionarëve për regjistrimin e shoqërisë në regjistrin publik të audituesve ligjorë;

iv. Statuti i shoqërisë;

v. Listën e audituesve të shoqërisë, përfshirë dhe administratorin, të cilët plotësojnë kushtet për të ushtruar profesionin e audituesit ligjorë dhe nuk janë ushtrues të profesionit si person fizik;

vi. Vërtetim nga prokuroria e rrethit se ndaj shoqërisë nuk është filluar çështje penale për vepra të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 4, të nenit 24, të ligjit për auditimin;

vii. Vërtetim nga gjykata e rrethit se shoqëria nuk është në proces gjyqësor për vepra të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 4, të nenit 24, të ligjit për auditimin;

b) Për audituesin/it ligjor/ë të regjistruar në shoqërinë e audituese paraqitet dokumentacioni si më poshtë:

i. Dokumentacioni i përcaktuar në shkronjat “c”, “ç”, “d”, “dh”, “e” dhe “gj”, sipas pikës 1, të nenit 11 të kësaj rregulloreje;

c) Për personat e angazhuar në organin drejtues ose administrativ dhe ortakët individë të shoqërisë audituese, si edhe pronari përfitues i shoqërisë audituese, të cilët nuk janë auditues ligjorë paraqitet dhe dokumentohet në dosjen e regjistrimit të shoqërisë së auditimit dokumentacioni si më poshtë:

i. Dokumentacioni i përcaktuar në shkronjat “c”, “ç”, “d”, dhe “dh”, sipas pikës 1, të nenit 11 të kësaj rregulloreje;

ç) Në rastin kur në pronësinë e shoqërisë së auditimit zotëruesi i kuotave është një person juridik (shoqëri jo-auditimi) paraqitet dhe dokumentohet në dosjen e regjistrimit të shoqërisë së auditimit të dhënat për të gjithë pronarët (individë) e fundit përfitues të individëve ortakë që nuk janë auditues ligjorë dhe të gjithë personave që janë pjesë e organeve të drejtimit apo kanë

autoritet vendimmarrës, si edhe dokumentacioni i përcaktuar në shkronjat “c”, “ç”, “d”, dhe “dh”, sipas pikës 1, të nenit 11 të kësaj rregulloreje.

2. Të dhëna e tjera, sipas nenit 29 të ligjit nr. 10091/2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

3. Dokumentacioni i paraqitur duhet të jetë në gjuhën shqipe dhe në përputhje me kërkesat ligjore të Republikës së Shqipërisë (origjinal ose i noterizuar).

4. Dokumentacioni që paraqitet për regjistrimin e shoqërive të huaja audituese në regjistrin publik të audituesve ligjorë përcaktohet në aktin nënligjor të miratuar nga Ministri i Financave.

Neni 14

Regjistrimi në përfundim të provimit të aftësisë profesionale

1. Pas përfundimit të provimeve të aftësisë profesionale, kandidatët që kanë fituar titullin auditues ligjor i drejtohen Komitetit të Regjistrimit me kërkesën për regjistrim për t’u pajisur me një numër individual.

2. Audituesi ligjor i adresohet Komitetit të Regjistrimit, përmes organizatës profesionale të audituesve ligjorë dhe dorëzon dokumentet e mëposhtme:

- i. Kërkesë për regjistrim e nënshkruar nga kandidati;
- ii. *Curriculum vitae*;
- iii. Dokument identifikimi biometrik i vlefshëm;
- iv. Vërtetim nga prokuroria e rrethit se ndaj shtetasit nuk është filluar çështje penale për vepra të lidhura me fushën e shërbimeve profesionale të auditimit ligjor, të kontabilitetit dhe konsulencës, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;
- v. Vërtetim nga gjykata e rrethit se kërkuesi nuk është në proces gjyqësor për veprë penale të kryer në fushën e shërbimeve profesionale të auditimit ligjor, të kontabilitetit dhe konsulencës, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;
- vi. Certifikatë e gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti), që tregon se kandidati për regjistrim nuk është i dënuar për asnjë veprë penale të kryer në fushën e shërbimeve profesionale të auditimit ligjor, të kontabilitetit dhe konsulencës, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;
- vii. Kopje e njehsuar e certifikatës së titullit auditues ligjor ose vërtetimin për përfundimin me sukses të provimeve të aftësive profesionale dhe përfundimin me sukses të praktikës profesionale.

3. Mbi bazën e këtyre dokumenteve, Komiteti i Regjistrimit pajis audituesit ligjorë me një numër individual. Organizata profesionale e audituesve ligjorë lëshon licencën profesionale, në të cilën shënohet numri individual i audituesit ligjor. Ushtrimi i profesionit në praktikë kryhet vetëm pas përfshirjes në regjistrin publik.

Neni 15

Pezullimi i veprimtarisë së audituesit ligjor

1. Audituesi ligjor, me një kërkesë për pezullimin e ushtrimit të veprimtarisë, mund të kërkojë të tërhiqet përkohësisht nga ushtrimi i profesionit.

2. Kërkesa për pezullim i drejtohet me shkrim Komitetit të Regjistrimit, përmes organizatës profesionale të audituesve ligjorë. Ajo duhet të jetë e motivuar dhe të tregojë veprimtarinë e re, që do të ndërmarrë i interesuari, si dhe periudhën për të cilën kërkohet pezullimi apo, kur kjo periudhë nuk mund të identifikohet, datën në të cilën kërkohet të fillojë pezullimi.

3. Komiteti i Regjistrimit e shqyrton kërkesën në mbledhjen e tij më të parë dhe nëse çmon se veprimtaria e tij e re nuk është e natyrës që u sjell dëm interesave etikë e moralë të profesionit, e miraton kërkesën dhe vendos fshirjen e përkohshme të të interesuarit nga regjistri publik i audituesve ligjorë. Dokumentet dhe faktet e deklaruara gjatë procedurave të pezullimit

të përkohshëm të ushtrimit të profesionit verifikohen nga Komiteti i Regjistrimit dhe në rastin kur konstatohen parregullsi të mundshme zbatohen dispozitat e ligjit për auditimin dhe të rregullores për investigimin dhe procedurat për marrjen e masave disiplinore.

4. Audituesi ligjor ka të drejtë të nisë veprimtarinë e re përpara marrjes së vendimit nga Komiteti i Regjistrimit, me kusht që të informojë për këtë, me shkrim, organizatën profesionale të audituesve ligjorë, të paktën dhjetë ditë më parë, të ketë shlyer derdhjen e kuotave të tij dhe të ketë pushuar veprimtarinë si auditues ligjor. Në rastet kur audituesi ligjor ka nisur veprimtarinë e re përpara marrjes së vendimit nga Komiteti i Regjistrimit dhe ky i fundit vëren, gjatë shqyrtimit, se veprimtaria e tij e re është e natyrës, që u sjell dëm interesave etikë e moralë të profesionit, vendos çregjistrimin e audituesit ligjor nga regjistri publik i audituesve ligjorë.

5. Komiteti i Regjistrimit kryen verifikimin, nëse natyra e veprimtarisë sjell dëm të interesave etikë e moralë të profesionit, duke u bazuar në përcaktimet e shkeljeve ose sjelljeve të papajtueshme të parashikuara në rregulloren për investigimin dhe procedurat për marrjen e masave disiplinore.

6. Nga data e njoftimit të vendimit, që shpall fshirjen e përkohshme nga regjistri publik, i interesuari nuk është më anëtar i organizatës profesionale. Ai nuk mund të ushtrojë në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e vet profesionin e audituesit ligjor të regjistruar dhe as ta përdorë këtë titull për shërbime të përcaktuara në ligj, angazhimi i të cilave është atribut i ushtruesit të profesionit të cilët janë pjesë e regjistrit publik.

7. Fshirja e përkohshme nga regjistri publik, me kërkesën e audituesit ligjor, nuk ka efekt mbi procedurat disiplinore, të nisura për shkeljet e kryera prej tij përpara fshirjes.

8. Efektet e pezullimit të ushtrimit të veprimtarisë fillojnë në datën më të hershme midis datës së kërkesës së audituesit ligjor për pezullim dhe datës së ndryshimit të kushteve të domosdoshme të lidhura me regjistrimin në regjistrin tregtar dhe/ose kushtet për pjesëmarrjen në kapital.

Neni 16

Ri-regjistrimi në regjistrin publik të audituesve ligjorë

1. Anëtar i tërhequr përkohësisht nga ushtrimi i profesionit mund të kërkojë ri-regjistrimin e tij.

2. Ri-regjistrimi nga Komiteti i Regjistrimit bëhet nëse audituesi ligjor ka përmbushur të gjitha detyrimet e kualifikimit të vijueshëm profesional edhe gjatë kohës kur ai nuk e ka ushtruar profesionin.

3. Audituesi ligjor i adresohet Komitetit të Regjistrimit, përmes organizatës profesionale të audituesve ligjorë dhe dorëzon dokumentet e mëposhtme:

a) Kërkesë për ri-regjistrim drejtuar Komitetit të Regjistrimit, e nënshkruar prej tij;

b) Vërtetim nga organizata profesionale e audituesve ligjorë për kryerjen e kualifikimit të vijueshëm profesional për kohën që nuk ka ushtruar profesionin e audituesit ligjor. Në rastin kur kryhen pranë organizatës profesionale ato dorëzohen nga organizata drejtpërdrejtë të Komitetit i Regjistrimit pa pasur nevojë për lëshimin e një vërtetimi. Në rastet kur kualifikimi i vijueshëm nuk është bërë pranë organizatës profesionale, një vërtetim nga institucioni në përputhje me dispozitat e ligjit për kryerjen e kualifikimit të vijueshëm profesional për kohën që nuk ka ushtruar profesionin e audituesit ligjor;

c) Dokument identifikimi biometrik i vlefshëm;

ç) Vërtetim nga prokuroria e rrethit se ndaj personit nuk është filluar çështje penale për vepra të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 4, të nenit 24, të ligjit për auditimin;

d) Vërtetim nga gjykata e rrethit se personi nuk është në proces gjyqësor për vepra të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 4, të nenit 24, të ligjit për auditimin;

dh) Certifikatë e gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti), që tregon se personi nuk është i dënuar për asnjë vepër penale të kryer në fushën e shërbimeve profesionale të auditimit ligjor, të kontabilitetit dhe konsulencës, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;

e) Deklaratë noteriale e lëshuar në përgjegjësinë personale të individit, për dhënien fund të papajtueshmërive, që kërkohen për ushtrimin e profesionit në praktikë dhe për garancitë etike e morale dhe të reputacionit të mirë;

ë) Vërtetim për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore;

f) Vërtetim nga organizata profesionale e audituesve ligjorë për shlyerjen e detyrimeve financiare lidhur me kuotat e anëtarësisë dhe detyrime të tjera;

g) Vërtetim nga BMP për shlyerjen e detyrimeve;

gj) Certifikatën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe kopje të Ekstraktit të QKB-së.

Neni 17

Çregjistrimi i audituesve ligjorë nga regjistri publik

1. Audituesi ligjor fshihet përfundimisht nga regjistri publik i audituesve ligjorë në rastet kur:

a) heq dorë nga e drejta për ushtrimin e profesionit. Heqja dorë bëhet nëpërmjet deklarimit me shkrim, kopje të të cilit i dërgohen organizatës profesionale dhe bordit të mbikëqyrjes publike;

b) konstatohen parregullsi në:

i. dokumentet e nevojshme, të lidhura me provimet e aftësisë profesionale;

ii. deklaratimet, të cilat rezultojnë të pavërteta, në lidhje me dhënien fund të papajtueshmërive, që kërkohen për ushtrimin e profesionit në praktikë dhe për garancitë etike e morale, të dorëzuara në çastin e bërjes së kërkesës për regjistrimin e parë në regjistrin publik;

iii. dokumentet e faktet e deklaruara gjatë procedurave të mundshme të pezullimit të përkohshëm të ushtrimit të profesionit;

c) në përfundim të një procedure disiplinore ndaj tij, është marrë masa disiplinore e çregjistrimit nga regjistri publik;

ç) është hequr e drejta e ushtrimit të profesionit, për shkak të ndryshimit të kushteve të domosdoshme për regjistrim, të lidhura me pjesëmarrjen në kapital;

d) për shkak të shkeljeve dhe masave disiplinore të përsëritura, reputacioni i të regjistruarit është cenuar ndjeshëm;

dh) në përputhje me dispozitat e këtij ligji, bordi ka vendosur çregjistrimin nga regjistri publik;

e) individi i regjistruar në regjistrin e audituesve ligjorë arrin moshën 67 vjeç, me përjashtim të audituesve ligjorë me titull shkencor “Doktor i shkencave” apo me titull më të lartë, të cilët çregjistrohen kur arrijnë moshën 70 vjeç;

ë) vdes.

2. Organizata profesionale e audituesve ligjorë publikon, në një aneks të veçantë të regjistrit publik të audituesve ligjorë, të gjithë individët e parashikuar në pikën 1, shkronja “e”, të këtij neni. Këta individë mund ta ushtrojnë profesionin e audituesit ligjor vetëm nëse janë të punësuar ose të angazhuar në një shoqëri auditimi, të regjistruar në regjistrin publik të audituesve ligjorë, që ka jo më pak se dy ortakë angazhimi dhe nën përgjegjësinë e kësaj të fundit.

3. Komiteti i regjistrimit do të shqyrtojë dhe marrë vendim pasi audituesi ligjor të ketë mbushur moshën e daljes në pension të parashikuar në nenin 26 të ligjit për auditimin dhe shkronjës “e” të pikës 1 të këtij neni.

4. Shoqëria audituese fshihet përfundimisht nga regjistri publik i audituesve ligjorë në rastet kur:

- a) përfundon afatin e ushtrimit të veprimtarisë së parashikuar në statutin e vet;
- b) e drejta për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri auditimi hiqet nga bordi.

Neni 18

Regjistrimi i përvitshëm

1. Komiteti i regjistrimit në mbledhjen e tretë të çdo viti shqyrton plotësimin e kushteve për ushtrimin e profesionit të audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese për regjistrimin e përvitshëm si më poshtë:

a) Detyrimin për orët e kualifikimit të vijueshëm profesional sipas nenit 25 të ligjit për auditimin gjatë vitit paraardhës, nëpërmjet listës së audituesve ligjorë për kryerjen e kualifikimit të vijueshëm profesional;

b) Shlyerjen e detyrimeve ndaj BMP-së dhe IEKA-s për periudhën raportuese paraardhëse;

c) Përditësimi i të dhënave të detyrueshme për publikim në regjistrin publik të audituesve ligjorë;

ç) Reputacionin e mirë.

2. Audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese duhet të paraqesin brenda datës 31 Mars, dokumentacionin që vërteton plotësimin e kushteve të shkronjës “a”, “b” dhe “ç”, të pikës 1, të këtij neni si më poshtë:

a) Dokument identifikimi biometrik i vlefshëm;

b) Një vërtetim nga institucioni në përputhje me dispozitat e ligjit të auditimit për kryerjen e kualifikimit të vijueshëm në rastet kur kualifikimi i vijueshëm nuk është bërë pranë organizatës profesionale;

c) Vërtetim nga BMP-ja dhe IEKA për shlyerjen e detyrimeve;

ç) Formular vetë deklarimi lidhur me sa parashikuar në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 4, të nenit 24 të ligjit për auditimin;

d) Vërtetim për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore;

dh) Certifikatë e gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti), që tregon se personi nuk është i dënuar për asnjë vepër penale të kryer në fushën e shërbimeve profesionale të auditimit ligjor, të kontabilitetit dhe konsulencës, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

KREU IV

PROCEDURAT E MBAJTJES DHE PËRDITËSIMIT TË REGJISTRIT PUBLIK NGA ORGANIZATA PROFESIONALE E AUDITUESVE LIGJORË

Neni 19

Organizimi dhe përditësimi i Regjistrit Publik

1. Organizata profesionale është struktura përgjegjëse që siguron:

a) mbajtjen dhe përditësimin e regjistrit publik të audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese;

b) identifikimin e audituesit ligjor dhe të shoqërisë audituese në regjistrin publik, me një numër individual;

c) mbajtjen dhe përditësimin e regjistrit dokumentar për të gjithë anëtarët jo aktiv (audituesit ligjor të tërhequr përkohësisht apo që nuk e ushtrojnë profesionin).

2. Informacioni për regjistrimin sipas shkronjës “a” dhe “b”, të pikës 1 të këtij neni mbahet në format elektronik dhe vihet në dispozicion të publikut nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare të organizatës profesionale të audituesve ligjorë. Për nevojat e veta, organizata profesionale e audituesve ligjorë mund të mbajë edhe regjistër në formë dokumentare.

3. Formati i regjistrimit publik të audituesve ligjorë miratohet nga BMP-ja dhe ai duhet të parashikojë të paktën dy seksione, të organizuara, përkatësisht, si seksioni i audituesve ligjorë dhe seksioni i shoqërive të auditimit.

4. Audituesi ligjor dhe shoqëria audituese, njoftojnë organizatën profesionale të audituesve ligjorë për ndryshimet e informacioneve të detyrueshme për publikim dhe të regjistruar në regjistrin publik sapo ndryshimi të ketë ndodhur. Në rast të ndryshimit të administratorëve apo kuotave të aksioneve, njoftimi shoqërohet me kopje të ekstraktit të QKB-së, kontratën e shitblerjes së aksioneve/të pjesëve, si dhe çdo dokument tjetër që gjykohet i nevojshëm.

5. Organizata profesionale, me marrjen e njoftimit dhe hartimin e relacionit për vlerësimin e plotësimit të kushteve të parashikuara në ligj, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit kryen përditësimin e informacionit të regjistrimit publik në faqen zyrtare të internetit.

6. Në rastet kur shkelen kushtet dhe/ose kur ndryshojnë rrethanat e parashikuara në këtë rregullore, të cilat konsiderohen të domosdoshme për regjistrimin e një audituesi ligjor apo shoqërie audituese, organizata profesionale vë në dijeni Bordin e Mbikëqyrjes Publike.

7. Organizata profesionale e audituesve ligjorë publikon, në një aneks të veçantë të regjistrimit publik, të gjithë individët e parashikuar në nenin 26, pika 1, shkronja “e”, të ligjit nr. 10091/2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Këta individë mund ta ushtrojnë profesionin e audituesit ligjor vetëm nëse janë të punësuar ose të angazhuar në një shoqëri auditimi, të regjistruar në regjistrin publik të audituesve ligjorë, që ka jo më pak se dy ortakë angazhimi dhe nën përgjegjësinë e kësaj të fundit.

8. Regjistri publik mbahet dhe publikohet në gjuhën shqipe.

9. Organizata profesionale e audituesve ligjorë ruan dosjen dhe dokumentacionin e regjistrimit në dosjen e audituesit ligjor për të paktën 10 vite dhe deri në çregjistrimin përfundimtar nga regjistri publik.

10. Organizata Profesionale e Audituesve Ligjorë kryen verifikimet në listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit gjatë procesit të regjistrimit ose përditësimit të regjistrimit publik.

11. Organizata profesionale e audituesve ligjorë përditëson regjistrin publik me vendimin e Komitetit të Regjistrimit sipas nenit 18 të kësaj rregulloreje.

12. Në rast të mos zbatimit të kërkesave të këtij neni do të zbatohen masat disiplinore të parashikuara në nenin 55/2 të ligjit për auditimin.

Neni 20

Seksioni i audituesve ligjorë

Seksioni i audituesve ligjorë në regjistrin publik duhet të përmbajë, të paktën, informacionin e mëposhtëm, në lidhje me audituesin ligjor:

- a) emrin, adresën dhe numrin e regjistrimit;
- b) sipas rastit, nëse audituesi ligjor është i miratuar për dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë;
- c) sipas rastit, emrin, adresën dhe numrin e regjistrimit të shoqërisë audituese, që ka punësuar audituesin ligjor, ose me të cilën ai ka lidhje ortakërie apo një formë lidhjeje tjetër;
- ç) të gjitha regjistrimet e tjera si auditues ligjor në vende të tjera, duke përfshirë emrin e Komitetit të Regjistrimit, si edhe të dhënat, nëse audituesi ligjor është i miratuar për dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë;
- d) masat disiplinore, të dhëna në adresë të audituesit ligjor apo vendimet e mëparshme, të marra nga autoritetet përgjegjëse, të cilat kanë pasur pasoja në regjistrim;
- dh) shkarkimet e mëparshme;
- e) të përmbajë informacion lidhur me autoritetin kompetent:

- i. për regjistrimin në regjistrin publik;
- ii. për mbikëqyrjen e sigurimit të kontrollit të cilësisë së auditimit në zbatim të nenit 4 dhe nenit 39 të ligjit të auditimit;
- iii. për kryerjen e investigimeve dhe marrjen e masave disiplinore dhe sanksioneve, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së auditimit ligjor dhe dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë, në zbatim të kreut VIII të ligjit të auditimit.

Neni 21

Seksioni i shoqërive të auditimit

1. Seksioni i shoqërive audituese në regjistrin publik duhet të përmbajë, të paktën, informacionin e mëposhtëm:
- a) emrin, adresën dhe numrin e regjistrimit;
 - b) formën ligjore;
 - c) informacione kontakti, të dhëna për administratorët kryesorë të subjektit apo për personin kryesor të kontaktit, si dhe adresën e faqes së internetit;
 - ç) adresën e çdo zyre në Shqipëri;
 - d) emrin dhe numrin e regjistrimit të të gjithë audituesve ligjorë si edhe të dhënat, nëse janë të miratuara për dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë, të punësuar nga kjo shoqëri auditimi dhe/ose të atyre që kanë lidhje ortakërie ose çdo lidhje tjetër me këtë shoqëri;
 - dh) emrat dhe adresat e biznesit të të gjithë ortakëve ose aksionarëve të shoqërisë;
 - e) emrat dhe adresat e biznesit të të gjithë anëtarëve të organeve të drejtimit ose administrimit;
 - ë) nëse është e mundur, anëtarësinë e rrjetit;
 - f) të gjitha regjistrimet e tjera si shoqëri audituese me autoritetet kompetente në vende të tjera, përfshirë Komitetin e Regjistrimit dhe numrin e datat e regjistrimit, si edhe të dhënat, nëse audituesi ligjor është i miratuar për dhënien e sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë;
 - g) vendimet e mëparshme, të marra nga autoritetet përgjegjëse, në adresë të shoqërisë audituese, të audituesve ligjorë të punësuar prej saj, të cilat kanë pasur pasoja në regjistër;
 - gj) rastet e mëparshme të zgjidhjes së parakohshme të kontratës për auditim ligjor;
 - h) të përmbajë informacion lidhur autoritetin kompetent:
- i. për regjistrimin në regjistrin publik;
 - ii. për mbikëqyrjen e sigurimit të kontrollit të cilësisë së auditimit, në zbatim të neneve 4 e 39 të ligjit të auditimit;
 - iii. për kryerjen e investigimeve dhe marrjen e masave disiplinore dhe sanksioneve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së auditimit ligjor dhe dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë, në zbatim të kreut VIII të ligjit të auditimit.

Neni 22

Kostot e regjistrimit

1. Administrimi i procesit të regjistrimit bëhet nga organizata profesionale e audituesve ligjorë.
2. Masa e tarifës së regjistrimit përcaktohet nga organizata profesionale e audituesve ligjorë, bazuar në kostot mesatare të regjistrimit me qëllim mbulimin e shpenzimeve, për procedurat e regjistrimit të përcaktuara në nenin 7 e kësaj rregulloreje.
3. Kostot e regjistrimit përballohen nga kandidatët që kërkojnë regjistrim, të cilët paguajnë një tarifë për regjistrim dhe çregjistrim.
4. Tarifa e regjistrimit është e ndryshme për kërkesat për regjistrim si shoqëri auditimi dhe për ato si auditues ligjor.

KREU V
MBIKËQYRJA E VEPRIMTARISË SË KOMITETIT TË REGJISTRIMIT DHE
ORGANIZATËS PROFESIONALE TË AUDITUESVE LIGJORË

Neni 23

Mbikëqyrja e zbatimit të procedurave

1. Organizata profesionale e audituesve ligjorë dërgon pranë Bordit të Mbikëqyrjes Publike raportin në përputhje me pikën 2, të nenit 7, të kësaj rregulloreje.

2. Sekretaria teknike e Komitetit të Regjistrimit duhet të njoftojë Bordin e Mbikëqyrjes Publike për rendin e ditës të mbledhjes, datën dhe orën e zhvillimit të saj, si edhe relacionin sipas rendit të ditës.

3. Bordi i Mbikëqyrjes Publike cakton një person nga struktura mbështetëse i cili mbikëqyr mbledhjet e Komitetit të Regjistrimit.

Neni 24

Mbikëqyrja nëpërmjet inspektimeve tematike

1. Bordi i Mbikëqyrjes Publike zhvillon inspektime tematike me objekt verifikimin e veprimtarisë së organizatës profesionale të audituesve ligjorë (IEKA) dhe të Komitetit të Regjistrimit, lidhur me zbatimin dhe pajtueshmërinë me dispozitat e ligjit për auditimin dhe të kësaj rregulloreje, si edhe verifikimin e dokumentacionit të dosjeve të regjistrimit të audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese.

2. Inspektimi kryhet nga Struktura Mbështetëse e BMP-së në format e mëposhtme:

a) Me vizitë në zyrat e organizatës profesionale të audituesve ligjorë (IEKA);
b) Në distancë nëpërmjet kërkesës për dhënie informacioni në përputhje me objektin e inspektimit.

3. Fazat e inspektimit do të jenë:

a) Njoftimi;
b) Vizita në terren sipas afateve të përcaktuara në vendim;
c) Lëshimi i raportit të inspektimit.

Neni 25

Shqyrtimi i ankimeve

1. Bordi i Mbikëqyrjes Publike shqyrton ankesat e bëra nga kandidatët, në lidhje me zbatimin e procedurave nga Komiteti i Regjistrimit dhe organizata profesionale e audituesve ligjorë.

2. Në rast se konstatohen shkelje apo sjellje të papajtueshme me kërkesat e ligjit për auditimin dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, Bordi i Mbikëqyrjes Publike, mund të fillojë një proces investigimi për të gjithë personat e përfshirë në vendimmarrje të cilët me veprimet ose mosveprimet e tyre kanë penguar zbatimin e kërkesave të ligjit për auditimin dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, si edhe kanë dëmtuar ndjeshëm reputacionin individual si zotërues të titullit AL ose Organizatës Profesionale të Audituesve Ligjor apo të Bordit të Mbikëqyrjes Publike.

3. Anëtarët e organeve drejtuese të organizatës profesionale të audituesve ligjorë dhe anëtarët e tjerë të zgjedhur, që mbajnë pozicione në strukturat drejtuese të tij janë përgjegjës për shkeljet administrative ose disiplinore të kryera gjatë ushtrimit të detyrave të tyre.

4. BMP-ja ka të drejtë të vendosë llojet e sanksioneve administrative sipas nenit 55/2 të ligjit të auditimit.

KREU VI
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 26

Dispozita të fundit dhe hyrja në fuqi

1. Ngarkohet organizata profesionale e audituesve ligjorë, Komiteti i Regjistrimit, Bordi Mbikëqyrjes Publike si dhe të gjithë subjektet e parashikuar në dispozitat më sipër për zbatimin e kërkesave të kësaj rregulloreje.

2. Organizata profesionale e audituesve ligjorë duhet të përcjellë rregullat e hollësishme të funksionimit të Komitetit të Regjistrimit dhe procedurat e marrjes së vendimeve e të miratimit të regjistrimit nga ana e Komitetit të Regjistrimit brenda 60 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

3. Në rast mospërputhje ndërmjet dispozitave të kësaj rregulloreje dhe akteve të tjera nënligjore të nxjerra nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, do të zbatohen dispozitat e kësaj rregulloreje.